

Tiranë, 04/11/2025

TERMAT E REFERENCËS

Emri: Instituti Liberal i Tiranës Pashko
Adresa: Rruga “Xhanfize Keko”, nr. 56, Tiranë
Email: info@ilp-al.org
Afati i dorëzimit: 14/11/2025

SHËRBIM EKSPERT MENTORIMI

SFONDI

Instituti Liberal i Tiranës Pashko, gjatë periudhës shkurt – nëntor 2025, po zbaton projektin “**DigiRinia – Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re**”, i financuar nga Bashkia e Kamzes. Projekti synon të aftësojë dhe përfshijë të rinjtë në zhvillimin dixhital përmes aktiviteteve formuese, informuese dhe ndërgjegjëse.

QËLLIMI I ANGAZHIMIT

Angazhimi ka për qëllim **përzgjedhjen dhe mentorimin e grupit të edukatorëve bashkëmoshatarë** nga shkollat “Gramoz Palushi” dhe “Ibrahim Rugova”, të cilët do të udhëheqin fushatën informuese “DigiRinia” në terren dhe online.

Eksperti do të zhvillojë një **seancë online përmes platformës Zoom**, me fokus fuqizimin e aftësive të pjesëmarrësve në drejtimin e fushatave ndërgjegjëse, komunikimin publik dhe përdorimin efektiv të mjeteve dixhitale.

DETYRAT KRYESORE

- Hartimi dhe zbatimi i një plani mentorimi për seancën online.
- Zhvillimi i një seance ndërvepruese (1 ditë) me grupin e përzgjedhur.
- Identifikimi dhe fuqizimi i liderëve të rinj që do të koordinojnë fushatën.
- Raportim përmbledhës mbi procesin dhe rezultatet e mentorimit.

KUALIFIKIMET E KËRKUARA

- Eksperiencë të mëparshme në mentorim, edukim rinor ose komunikim publik.
- Njohuri mbi fushatat ndërgjegjëse dhe pjesëmarrjen e të rinjve.
- Aftësi për të drejtuar trajnime online dhe për të inkurajuar ndërveprim.

DORËZIMI I OFERTAVE

Ofertat duhet të dërgohen me email në adresën info@ilp-al.org brenda datës 14/11/2025. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe .

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

- Ofertë financiare në lekë
- NIPT ose dokument identifikimi i ofertuesit

VLERËSIMI I OFERTAVE

Ofertat do të vlerësohen mbi bazën e raportit çmim-cilësi dhe përputhshmërisë me specifikimet teknike. Ofertat që tejkalojnë buxhetin maksimal do të refuzohen automatikisht.

FURNIZIMI/SHËRBIMI I KËRKUAR

Furnizimet e kërkuara janë përshkruar në Termat e Referencës.

AFATET KOHORE

Afati për dorëzimin e ofertave: **14.11.2025, ora 23:59**

(Të gjitha oraret janë përcaktuar sipas orës lokale të autoritetit kontraktues)

PJESËMARRJA DHE NËNKONTRAKTIMI

- Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë.
- Nëse përdoret nënkontraktor, duhet të jepet emri, vlera dhe përqindja përkatëse në ofertën financiare.

PYETJE PARA AFATIT TË DORËZIMIT

- Pyetjet mund të dërgohen me email në: deri më **11.11.2025**.
- Nuk do të zhvillohet takim apo vizitë në zyrë.

DORËZIMI I OFERTAVE

Vetëm nëpërmjet emailit në: info@ilp-al.org deri më **14.11.2025, ora 23:59**.

SHPENZIMET E OFERTUESIT

Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nuk rimbursohen.

VLERËSIMI I OFERTAVE

- Nuk parashikohet intervistë.
- Ofertat mbi buxhetin maksimal do të refuzohen.
- Përzgjedhja bëhet mbi parimin **çmim-cilësi**.

ETIKA DHE PRAKTIKAT E NDALUARA

- Çdo përpjekje për ndikim të padrejtë në procedurë do të çojë në përjashtim.
- Ndalohe konflikti i interesit dhe shpenzimet e pazakonta komerciale.



NËNSHKRIMI I KONTRATËS

- Ofertuesi fitues njoftohet dhe duhet të nënshkruajë kontratën brenda **30 ditëve**.

ANULIMI I PROCEDURËS

Autoriteti kontraktues mund të anulojë procedurën në raste të veçanta, si: mungesë ofertash të vlefshme, ndryshime të rëndësishme, forca madhore, tejkalim buxheti ose shkelje në proces.

FORMULARI I DORËZIMIT TË SHËRBIMIT

Aktiviteti 2.2, 2.3, 2.3.1: Mentorimi, krijim dhe fuqizimi i Grupit te Edukatoreve bashkemoshatare.

Projekti: “DigiRinia-Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re”

Shuma totale e ofertës:

Nr.	Shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Mentorimi, perzgjedhja dhe fuqizimi i grupit te edukatoreve.	Fee	1	85 000	85 000

Nënshkruar në emër të Ekspertit

Emri & Mbiemri:

Firma:

